




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. 2-D/DPK	Br. Prot. 01-2676/14
Dep.	Prot. No.
Nr. I faq.	Data
Broj stranica 02	Datum 18-07-2014
Nr. pages	Date
PRISHTINË	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.07.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-2012/14, për z. Agim Hoxha, ish Anëtar i Kuvendit Komunal në Gjakovë, për shkak se nuk ushtron funksion publik

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Agim Hoxha, ish Anëtar i Kuvendit Komunal në Gjakovë, dhe njëkohësisht, person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Hoxha është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas së cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë me ç'rast është kuptuar se tashmë ish zyrtari i lartë z. Hoxha nuk e ushtron më funksionin e Anëtarit të Kuvendit Komunal në Gjakovë, dhe po ashtu nuk ka asnjë funksion tjetër publik.

Duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit konsiderojmë se nuk kemi situatë të shkeljes së dispozitave të këtij Ligji, zyrtari i lartë z. Hoxha pas dorëheqjes nga funksioni publik mund të ushtroj pozitën e personit të autorizuar në biznesin privat, Sh.P.K "Compania Fati", prandaj pushojnë hetimet për Konflikt Interesi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

